There are many Serbs who are willing to participate in Kosovo's institutions but they are intimidated, said a speaker, adding that there are currently about "8,000 applications for Kosovo IDs pending with the Kosovo institutions and about 2,000 people from the north are currently on the Kosovo government's payroll." The speaker said that Kosovo's government is willing to invest in the north but the Serbs do not accept Kosovo government funds. There are a number of projects underway, such as the cemetery maintenance and installation of lights in the vicinity of churches. The government spent about half a million euros on four projects in 2011. The project proposals came from the local Serbs. The speaker said that not all parallel structures are criminal or illegal and added that Serbia-funded health and education services should remain.

A speaker familiar with the Serbian structures in the north said that they also support the resolution of the crisis through peaceful means, but, according to him, the Serbs in the north are avoiding communication with Pristina because Pristina says they are criminals and corrupted people, referring also to the mayors. He said that EULEX should treat both communities equally. "It is on the side of the Albanians for now." He explained that Serbs in the north cannot

discuss the Ahtisaari plan as long as the Serbian government doesn't recognize it. "President Tadic has said that if the Ahtisaari plan would be implemented, the Serbs in Kosovo would vanish." He suggested issues such as IDPs and refugees as first topics for eventual discussions between Pristina and Serbs in the north. He also asked Pristina to pledge that it would not resort to violence in resolving disputes. He admitted that some Serbs get pensions and IDs from Pristina, but said that Albanians did the same in the 1990s. Some Albanian speakers said that "Albanians had no alternative documents in the 1990s. Serbs do." Regarding the Serbian local elections, the speaker said that they should be held even if they are in violation of UN Resolution 1244. "Albanians violated 1244 first. They declared independence and organized elections independently. According to 1244, only UNMIK has the right to call elections." The speaker said that the big issues should be discussed at higher levels, with authorities in Belgrade. "We can talk about daily problems citizens face, such as garbage collection, water supply, but not status issues."

An Albanian speaker said that Kosovo Serbs in the north cannot say that they are not offered rights. "They refuse them." He said that those living in the north should be given more information about what happens in the rest of Kosovo. Kosovo television should be made available in the north just as Serbian television stations are available in the south. He suggested that the Ahtisaari plan should be explained to the people. "The Serbs in the north should tell us what the Ahtisaari plan is not providing." The speaker agreed that the local authorities in the north do not have power to discuss bigger political issues. He said that it would be difficult to build confidence between the communities given that young Serbs and Albanians have not been communicating for over twenty years. He suggested that communication should also be established between less politicized groups such as professionals in areas of education and healthcare.

A Serb speaker said that it was very useful to be again in contact with former colleagues, and suggested that they should initiate informal discussions themselves. She suggested that Belgrade authorities should invite Kosovo Serb representatives to Belgrade or come themselves to Kosovo and "ask us what we want, what we need, and how do we see the solutions of the outstanding problems." Another speaker, however, said that what local people think in the north is irrelevant to decision-makers in Belgrade and Pristina. He said that the north is a problem for everyone. He suggested addressing practical problems first, such as unemployment. Regarding the returns, the speaker said that unfortunately the process is over. "These people will never return. They have built their new lives elsewhere."

The identity issue also came up. A Serb participant said that the Serbs in the north will not take Kosovo IDs and other documents that say they are 'Kosovars.' Another participant said that the identity issue is a problem for everyone: "If one

can't convince even the Albanians that they are Kosovars, how can one convince the Serbs?" In conclusion, the participant said that the implementation of the agreements is key and he did not expect addressing the resolution of the issues of the north until 2013.

Conclusions and Recommendations

A number of conclusions and recommendations emerged from the roundtable. These were made by individuals or by groups of individuals and were not based on consensus.

- Pristina should make clear that it wants to have an open channel of communication with the Serbs in the north including those heading the parallel institutions there. Now that Pristina is accepted as interlocutor by Belgrade, it should also be acceptable for the Serbs in the north.
- Belgrade will have a new government and most likely new politics. Whether the politics toward Kosovo will change remains to be seen. A government with strong parliamentary support can deal with the issues of the north more effectively.
- A dialogue between Pristina and the Serbs on the north is desirable. A sustainable solution without the presence of Belgrade in this dialogue will be difficult to achieve.
- Agreements reached in Brussels should be implemented fully and swiftly.
- The barricades should be removed and freedom of movement should be established for all in the north, as well as freedom of movement within all of Kosovo, for the Albanians to travel in the north and for the Serbs to travel in the south.
- The ground should be prepared for conducting Kosovo elections in the north.
- Belgrade does not have to recognize Kosovo's independence but should accept Kosovo as a single territorial unit and stop funding parallel structures on Kosovo's territory.
- All sides should strive to strengthen security and refrain from actions that lead to violence while preparations for dialogue are under way.
- Belgrade, Pristina, and Kosovo Serbs should understand that there would be no partition of Kosovo or exchange of territories.
- Confidence is reached through results. Serbs in north Mitrovica should talk to Albanians in south Mitrovica. The two mayors should sit together first and then have experts from two municipalities cooperate on resolving various problems (waste collection, water supply, heating, electricity, etc.). Such

meetings could later be extended to other Serbian mayors in the north. The mayors of the four Serbian municipalities in the north could later sit down with the mayor of Mitrovica and other neighboring municipalities and establish a permanent working table, organize meetings once a week.

- Serbia's security and intelligence structures should withdraw from the north. They are an obstacle to the implementation of the agreements and a key source of tensions in the north.
- Serbs in the north have a communication problem with Belgrade and with Serbs in the south.
- Serbs in the north should know more about the Ahtisaari plan to assure that their position against the Ahtisaari plan is an informed one.
- Belgrade should be transparent and disclose the details of the agreements reached with Pristina and informal agreements with the EU and its commitments given to the EU.
- All sides should calm down the rhetoric. One cannot have meaningful dialogue if people are sending aggressive messages.
- Undertake confidence-building measure: evaluation of agreements; clarification of criminal allegations; establishment of a clear and transparent court system in the north; Kosovo Police Service should be professionalized and reformed, perhaps through inclusion of Serbs in Kosovo's special police units; trust in KFOR and EULEX should be improved; increase cooperation of the police with citizens.

OVERALL CONCLUSIONS

The search for a compromise and mutually accepted solutions for the north of Kosovo is at a very early stage. The sides are very far from each other. One thing, however, was clear to the participants in both Vienna and Pržno: the problem of the north is a political problem and should be dealt by political means.

The key prerequisite for the start of such a process is strengthening security in the north. All sides should understand that there would be no partition of Kosovo or exchange of territories. All remaining barricades there must be removed and freedom of movement should be established and guaranteed for everyone. Political leaders and the media should calm down the rhetoric. There can be no meaningful dialogue while the aggressive language is being exchanged.

Establishing communication and trust between sides is crucial. The gap between Serbs and Albanians and their mutual distrust and suspicion of each other are overwhelming. Further discussions of the type organized by CIG would be a serious contribution toward further normalization of relations.

Dialogue should be organized on several levels.

Dialogue on practical issues between the political representatives of south and north Mitrovica would not only establish a point of permanent contact for the local officials but would also seek to resolve many real life issues and problems through which confidence can be reached.

Any resolution requires a dialogue between the political leaders of Serbs in the north and leaders of Kosovo's institutions. Pristina should make it clear that it wants to have an open channel of communication with all Serbs in the north including those who are chosen by the Serb community there to represent them. These politicians represent an important part of the political spectrum in the north and influence citizens there. Those who have not committed any crimes and want to stay engaged in politics should have a political future within Kosovo's political system.

The politicians in the north should accept Pristina as an interlocutor. Now that Pristina is accepted as interlocutor by Belgrade, it should also be acceptable for the Serbs in the north.

However, as acute as the crisis in the north might be, its resolution is impossible without the active engagement of Pristina and Belgrade, their bilateral political dialogue, and without the continuing assistance of the international community.

A number of confidence-building steps are possible even before a resolution of the crisis in Kosovo's north is reached. Participants identified the issues of security and the rule of law, and especially the functioning of the police and the justice system, securing property rights, unemployment, the organization of local

self-governance in the north and fears of losing their Serb identity, as important issues on which they were willing to engage in discussions with their Albanian counterparts. These issues, albeit general in nature, merit further exploration. The suggested dialogue between the Kosovo institutions and all influential political actors in the north would be a good start and a good venue for it.

KËRKIM PËR ZGJIDHJE PËR VERIUN E KOSOVËS

Parathënie dhe mirënjohje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka qenë i zënë me çështjet lidhur me Kosovën që nga fillimi i punës së tij në vitin 2010. Nga qershori i vitit 2010, ne kemi qenë duke zhvilluar programin e dialogut serbo-serb duke sjellë në tavolinën e diskutimeve fraksione të ndryshme, shpesh të kundërta politike të serbëve në Kosovë si dhe zyrtarë nga Beogradi me qëllim të përparimit të komunikimit mes këtyre grupeve dhe me qëllim të përmirësimit të politikave të cilat i drejtohen serbëve të Kosovës. Në këtë frymë, rekomandimet e politikave janë prodhuar nga pjesëmarrësit dhe janë formuluar nga CIG në maj të vitit 2011. *Rekomandimet e Politikave për Akomodimin e Serbëve në Kosovë* mund të gjendet në faqen tonë të internetit www.cigonline.net. Që nga viti 2011, zyrtarë shqiptarë të qeverisë dhe parlamentit të Kosovës si dhe përfaqësues të shoqërisë civile kanë qenë pjesë aktive e aktiviteteve të programit të ri të CIG duke zgjeruar kështu diskutimet dhe duke përfshirë çështje rreth marrëdhënieve mes serbëve të Kosovës dhe qeverisë së Kosovës e posaqërisht ndërmjet serbëve të veriut dhe Prishtinës.

Këto programe janë mbështetur financiarisht nga Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme.

Dy prej diskutimeve të cilat janë të përfshira në këtë raport janë mbajtur në dhjetor të vitit 2011 në Vjenë të Austrisë, dhe në mars të vitit 2012 në Przhno të bregdetit të Adriatikut në Mal të Zi. CIG ka bashkuar në tryezën e diskutimeve në vende neutrale e joformale udhëheqës të partive, analistë dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga Kosova e Serbia si dhe diplomatë evropian e amerikan.

Për pjesën më të madhe të pjesëmarrësve, këto diskutime kanë qenë hera e tyre e parë e komunikimit të drejtpërdrejt qysh nga koha e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008.

Idea për mbajtjen e këtyre takimeve ka dalë nga bisedat e ndara me politikanë e analistë në Kosovë e Serbi përgjatë verës dhe vjeshtës së vitit 2011. Mendimet e tyre na kanë ndihmuar për të hartuar agjendat e diskutimeve.

Qëllimi i këtyre takimeve të CIG ka qenë krijimi i kushteve për udhëheqësit e Kosovës e Serbisë për kërkimin e zgjidhjeve për situatën mjaft të tensionuar në veri të Kosovës që u përshkallëzua në verë të vitit 2011, për identifikimin e disa hapave afatshkurtër dhe afatgjatë që mund të ndërmerren për ndërtimin e besimit mes dy palëve, si dhe për t'i inkurajuar palët që të shkëmbejnë pikëpamjet rreth rigjenerimit të dialogut serbo-shqiptar, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës e në vecanti në mes serbëve në veri dhe institucioneve të qeverisë së Kosovës.

Cështja e veriut të Kosovës, sot është njëra nga çështjet më të ndërlikuara në Evropën juglindore. Ky problem kërcënon stabilitetin jo vetëm të Kosovës e Serbisë por edhe të shteteve fqinje gjithashtu. Zgjidhja e këtij problem do të ndikojë drejtpërdrejt në qëllimin kryesor të politikës së jashtme të Serbisë e Kosovës – antarësimin e tyre eventual në Bashkimin Evropian.

Në njërën anë, takimet kanë konfirmuar një numër të madh të ideve rigjide e të paragjykuara për vështirësinë e madhe të përballjes me problemin e veriut, si dhe kanë konfirmuar idenë se zgjidhja e këtij problem do të kërkojë një process të gjatë e të mundimshëm. Në anën tjetër, nga bisedat është parë qartë se një numër i masave për ndërtimin e besimit janë të mundshme dhe duhet të implementohen pa vonuar. Shpërthimet e fundit të dhunës në veri dëshmojnë për rëndësinë e masave të tilla. Lexuesi do të mund ti shohë këto të përshkruara në këtë tekst.

Diskutimet poashtu kanë vënë në pah brenga valide për serbët në jug. Është bërë e qartë se çështja e veriut nuk mund të shihet e izoluar por duhet të konsiderohet si pjesë e problemit të përgjithshëm të akomodimit të serbëve që jetojnë në Kosovë, si në veri ashtu edhe në jug.

Përkundër pikëpamjeve të kundërta, vetë fakti që pjesëmarrësit janë bashkuar dhe janë pajtuar të kërkojnë mënyra të pranueshme për secilën palë për zgjidhjen e status quo-së së paqëndrueshme në veri, na jep të gjithëve shpresë se ky problem i vështirë mund të zgjidhet me mjete paqësore. Sipas pjesëmarrësve, një gjë e tillë do të kërkojë vazhdim të dialogut, vetëpërbajtje dhe punë të palodhshme në përmirësimin e kushteve ditore të atyre që jetojnë në veri. Se a do të bëhet kjo realitet varet nga udhëheqësit politik të të gjitha anëve.

Problemet e serbëve e shqiptarëve janë të ndërlidhura. Do të marrë një kohë të gjatë para se çështjet të ndahen dhe para se të zgjidhet mosmarrëveshja serbo-shqiptare. Ne shpresojmë se këto diskutime të organizuara nga CIG do ta shkurtojë këtë kohë.

Në u jemi shumë falenderues pjesëmarrësve për kontributin, disiplinën, durimin dhe respektin që kanë treguar për njëri tjetrin, gjëra këto që kanë qenë kyce për suksesin e këtyre aktiviteteve. CIG shpreson ta vazhdojë këtë dialog dhe planifikon të organizojë takime të këtij lloji shumë shpejt.

Ne i jemi shumë falenderues kolegëve dhe miqve tanë nga Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme, me theks të vecantë Caroline Tissot, Norbert Rüttsche dhe Roland Salvisberg për përkrahjen e tyre të pazezervë për aktivitetet e CIG si dhe për bashkëpunimin e tyre permanent. Pa inkurajimin e tyre, këto takime nuk do të ishin të mundura. Pjesëmarrja e tyre konfirmon kontributin e rendësishëm dhe të vazhdueshëm që diplomacia zvicrrane është duke dhënë në krijimin e paqes së qëndrueshme në Ballkan. Gjithashtu i jemi

mirënjohës Lawrence Meredith nga Komisioni Evropian për pjesëmarrjen e tij shumë efikase në të dyja takimet dhe për kontributin e tij të pashtershëm si dhe kolegëve të tij në Bruksel, Stefano Sannino dhe Pierre Mirel për përkrahjen e tyre të vazhdueshme të përpjekjeve tona dhe besimit në misionin tonë.

Shfrytëzojmë këtë mundësi për të falenderuar kryesuesin e bordit të drejtorëve të CIG, profesorin Steven L. Burg, për pjesëmarrjen e tij aktive dhe për këshillat për drejtimin e punës së CIG. Me këtë rast poashtu duam t'i falenderojmë edhe anëtarët tjerë të bordit, Gordon N. Bardos dhe Michael W. Elf për këshillat dhe përkrahjen e vazhdueshme.

Nënkryetari i CIG Shpëtim Gashi ka qenë i pazëvendësueshëm në implementimin e kësaj iniciative. Ne poashtu dëshirojmë të falenderojmë kolegët tanë në Evropë Arbër Kuçi, Ivana Stanojev dhe Marija Govedarica për kontributin e dhënë.

CIG merr përgjegjësinë e plotë për këtë raport i cili nuk është lexuar nga pjesëmarrësit.

Alex N. Grigorev, Kryetar

*Nju Jork
Maj 2012*

TRYEZA E RRUMBULLAKËT NË VJENË

Përmbledhje e Diskutimeve

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) në dhjetor të vitit 2011, në Vjenë të Austrisë, ka organizuar një tryezë të rrumbullakët për përfaqësues serbë dhe shqiptarë nga partitë politike dhe qeveria. Pjesëmarrësit përfshinin anëtarë nga partitë politike të Serbisë, si Partia Demokratike, Partia G17 Plus, Partia Socialiste e Serbisë, Partia Liberal Demokrate, dhe anëtarë nga partitë politike të Kosovës, si Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje, Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës, Partia e Pavarur Liberale, Lista e Bashkuar Serbe, si dhe një numër analistësh nga Beogradi dhe Prishtina. Poashtu morën pjesë diplomatë nga Zvicra, BE-ja dhe SHBA-të. Tryeza është financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës.

Idea për këtë takim lindi nga bisedat e CIG-ut me shumë nga të ftuarit gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011. Një numër i konflikteve të pazgjidhura të Ballkanit perëndimor, prej të cilave më e ngutshmjia është situata e tensionuar në veriun e Kosovës, pengojnë vendet e rajonit nga sigurimi i stabilitetit dhe lëvizjes më ritëm më të shpejtë drejt cakut të tyre të përbashkët, antarësisimit në Bashkimin Europian. CIG organizoi takimin në Vjenë për të ndihmuar krijimin e ideve të reja se si të zgjidhet çështja më urgjente me të cilën ballafaqohet rajoni sot.

Pyetjet e agjendës ishin të grupuara rreth temës kryesore “Çfarë nevojitet për zgjidhjen e problemeve të veriut të Kosovës.” Pjesëmarrësit ishin ftuar për t’i identifikuar mënyrat e zgjidhjes së krizës në veri të cilat nuk janë relevante për tu diskutuar dhe ato të cilat duhet të shqyrtohen më tej. Pjesëmarrësit u inkurajuan që t’i identifikojnë problemet kryesore me të cilat përballen ata të cilët jetojnë në veri dhe të propozojnë zgjidhje që do të ishin më të mirat për t’i zgjidhur ato, t’i identifikojnë kriteret të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e pranueshme për të gjitha palët, të shikojnë për mundësitë e bashkëpunimit që ekzistojnë për Prishtinën, Beogradin dhe serbët e veriut për ta zgjidhur konfliktin, si dhe t’i identifikojnë masat e mundshme për ta ndërtuar besimin e ndërsjellë.

Sikurse në të gjitha tryezat e mëdha si kjo, jo të gjitha objektivat e agjendës janë përmbushur dhe kërkojnë një takim pasues. Në vijim është përmbledhja e diskutimeve të Vjenës dhe përfundimet e tyre. Për të inkurajuar diskutime të hapura, komentet nuk ua janë atribuar diskutuesve specifik dhe CIG kërkon mirëkuptimin e atyre, të cilëve komentet nuk u janë kapur plotësisht në këtë raport të shkurtër. Pjesëmarrist morrën pjesë në këtë tryezë të rrumbullakët në cilësinë e tyre personale dhe qëndrimet e tyre jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të organizatave të cilat i përfaqësojnë. Pjesëmarrësit nuk e kanë rishikuar raportin, dhe CIG mban përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

Argumentet hyrëse

Dy analistë nga Beogradi dhe Prishtina e hapën diskutimin. Ata paraqitën një vështrim mbi marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës dhe një analizë të situatës aktuale në veri. Pjesëmarrësi nga Beogradi adresoi marrëdhënien ndërmjet mjerimit ekonomik dhe ekstremizmit politik. Ekonomia e dobët, e karakterizuar nga nivele ekstreme të papunësisë – rreth 45 për qind në Kosovë dhe 20 për qind në Serbi – nuk po e prekë vetëm jetën e serbëve dhe shqiptarëve, por poashtu qëndrimet politike të Beogradit e Prishtinës. Ai argumentonte që në kohë të vuajtjes ekonomike kapja për nacionalizëm është mënyra më e mirë për elitën që ta zgjasë qëndrimin e saj në fuqi dhe që ta shmangë vëmendjen e publikut nga çështjet e vërteta. Që të dyja, si Beogradi ashtu dhe Prishtina përballen me deficite të buxhetit, rritje të dobët ekonomike, korrupsion dhe krim të organizuar të përhapur. Ai propozoi që Beogradi dhe Prishtina do të duheshin të fillonin një bashkëpunim të sinqertë, dhe jo vetëm atëherë kur një gjë e tillë kërkohet nga komuniteti ndërkombëtar.

Në lidhje me krizën në veri të Kosovës, folësi tha që mosmarrëveshja nuk qëndron vetëm ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, por poashtu ndërmjet Beogradit dhe serbëve të veriut, Prishtinës dhe këtyre serbëve, ndërmjet Beogradit dhe komunitetit ndërkombëtar, dhe ndërmjet Prishtinës dhe komunitetit ndërkombëtar. Beogradi do të duhej të mbështeste zgjidhjet nga të cilat do të përfitonin si serbët në veri të Kosovës poashtu edhe ata në jug, shtoi folësi. Ai poashtu tërqohi vërejtjen kundër “kriminalizimit të barrikadave në veri.” “Ndërsa disa persona tek barrikatadat mund të jenë kriminelë, problemi është real.” Sipas argumentit të tij, burimi i problemit nuk është shkëlja e ligjeve, shkëlja e ligjeve është thjeshtë rezultat, e jo shkak, i konfliktit. As Beogradi e as Prishtina nuk mund të funksionojnë dhe të përparojnë më një rrezik të tillë të përhershëm politik e të sigurisë. Thirrja e presidentit Tadiq për largimin e barrikadave nuk është konsideruar serioze nga disa akterë, ngase thuhet që zyrtarët serbë kishin marrë masa për të parandaluar zbatimin e mesazhit të presidentit. Folësi konkludoi se qeveria e Kosovës ka përfituar nga kjo situatë, më së shumti për shkak se nuk ka vepruar, duke përfituar kështu nga mosveprimi.

Analisti nga Prishtina e hodhi poshtë argumentin që dëgjohej shpesh se serbet dhe shqiptarët nuk mund të jetojnë së bashku. “Nuk ka shumë kuptim të thuhet që serbët dhe shqiptarët nuk mund të jetojnë së bashku në Kosovë, por grupe të tjera etnike në vende tjera munden—për shembull, shqiptarët në Serbi dhe Maqedoni, rusët në Ukrainë dhe hungarezët në Rumanë.” Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik la 25 milion rusë jashtë Rusisë dhe ata duket se janë akomoduar në shtetet e tyre të reja përkatëse, deklaroi folësi. Ai poashtu vuri në pikëpyetje argumentin që serbët e veriut janë kundër integritimit për shkak të frikës së tyre nga Prishtina, duke shtuar që sipas kësaj logjike frika do të duhej të ishte më e

madhe tek serbët në jug sesa tek ata në veri. “Serbët e veriut jetojnë të vetëm në veri, atehërë përse të frigohen! Nga ana tjetër, serbët e jugut jetojnë në zona të rrethuara nga një popullatë shqiptare.”

Analisti nga Prishtina theksoi se qasja e Beogradit është çelësi i integritetit të serbëve të veriut në institucionet e Kosovës, por tha se Beogradi është duke e bërë të kundërtën. “Beogradi është duke i shfrytëzuar serbët e veriut për të ushtruar tryzni mbi politikën e Kosovës dhe për të mbajtur cështjen e statusit të Kosovës të hapur”. Folësi shkurtimisht adresoi opsionet e mundshme për veriun. Ai tha që ndarja nuk është zgjidhje e mundshme, kryesisht për shkak se akterët kryesorë e kundërshtojnë fuqishëm një gjë të tillë. Ndarja, sipas po të njejtit analist, poashtu do të kishte pasoja për rajonin, sidomos për Bosnje e Hercegovinën dhe Maqedoninë. Shkëmbimi i territoreve është poashtu opsion që ka pak gjasa të ndodhë. Ky opsion është i mbështetur nga disa pjesë të shoqërisë serbe dhe asaj shqiptare por kundërshtohet nga komuniteti ndërkombëtar. Ndarja do të mund të arrihej nga bisedime të fshehta ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, por që tani për tani mbetet opsion i pamundur. Një opsion i tretë, modeli i planit të Ahtisaarit “Plus” që do të ofronte të drejta shtesë për serbët në veri, kundërshtohet nga shqiptaret kryesisht për shkak të frikës se dikë do të frenonte funksionimin e shtetit, si dhe nga Beogradi dhe serbët e veriut ngaqë e lë veriun brenda Kosovës. Opsioni i katërt, një mini-protektorat i përkohshëm që do të forconte sundimin e ligjit do të mund të ishte më i pranueshëm për Beogradin dhe Prishtinën por komuniteti ndërkombëtar nuk duket të jetë i gatshëm për ti siguruar resurset e nevojshme për këtë opsion, konkludoi folësi.

Pikat kryesore të diskutimit

Beogradi dhe serbët e Kosovës

Një pjesëmarrës serb nga veriut argumentonte se “Beogradi mund ta përdorë veriun për të mbajtur ndonjë lloj kontrolli mbi Kosovën por as Prishtina nuk është e interesuar për të ndërtuar partneritet, për më shumë ajo dëshiron t’ju bën dëm të tjerëve, sidomos kur thotë se strukturat kriminale e sundojnë veriun.” Ai pranoi që ka disa kriminelë në veri sikurse në jug, por tha që ata nuk kanë mjaft ndikim për të drejtuar kursin e ngjarjeve. “Kriminelët në veri nuk janë problemi, ata janë rezultat i problemit.” Ai tha që ndërkombëtarët dhe shqiptarët kanë pak ndikim në veri, dhe se vetëm Beogradi mund ta zgjidhë këtë krizë.

Ky pjesëmarrës shtoi që konstatimet që serbët e veriut janë peng të Beogradit apo kriminelëve nuk janë të vërteta. “Serbët e veriut thjeshtë duan që fatin e tyre ta marrin në duart e tyre.” Në mënyrë që të ketë sukses ndonjë zgjidhje, serbët e veriut duhet të jenë pjesë qenësore e çfarëdo diskutimi për veriun. Ai theksoi që ata nuk do të duhej të hiqnin dorë nga privilegjet që kanë tani—

pavarësia e qeverisjes lokale, institucionet lokale serbe, pavarësia e shërbimeve sociale (institucionet shëndetësore dhe edukative, etj.)—por vetëm mund të kërkojnë më shumë. Ai poashtu tha që institucionet në veri nuk janë paralele por të vetmet që ekzistojnë në veri, edhe pse pranoi që ato janë institucione të Serbisë e jo të Kosovës, që është thelbi i problemit. Plani i Ahtisaarit është i papranueshëm për serbët e veriut, sepse i jep Kosovës pavarësi dhe nuk ofron siguri të mjaftueshme dhe garancë institucionale për komunitetin serb. Ai tha se vetëm një plan që ofron kornizë të fortë institucionale do të ishte i pranueshëm për serbët e veriut, por nuk dha detaje se si do të dukej një plan i tillë. Sipas tij, një zgjidhje për veriun është urgjente.

Perspektivat e serbëve të Kosovës

Dy realitete serbe ekzistojnë në Kosovë: veriu dhe jugu, tha një pjesëmarrës tjetër serb nga veriu, duke argumentuar që serbët në jug në njëfarë mënyrë janë ‘të detyruar’ të integrohen në institucionet e Kosovës, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, marrjen e letërnjoftimeve dhe tabelave të veturave, kurse serbët e veriut nuk duhet të integrohen. Ata frikësohen nga humbja e identitetit serb: “Ne thjeshtë nuk duam të jemi pjesë e Kosovës. Ne nuk duam që dokumentet e Kosovës të thonë që jam kosovar dhe jo serb. Zgjidhje është ndonjë formë e përshtatjes së kufijve.”

Një numër i serbëve të jugut argumentonin që serbët e Kosovës të jugut nuk ishin të detyruar ta pranonin ‘realitetin e hidhur’ por më shumë e shihnin integrimin si opsion më të mirë për ti përmirësuar kushtet e tyre të jetesës. Një pjesëmarrës serb nga jugu poashtu kundërshtoi idenë e ndarjes, duke thënë se një gjë e tillë do të krijonte pasoja të shumta për serbët në jug të lumit Ibër. Ai shtoi që çfarëdo zgjidhje për veriun e Kosovës nuk mund të bëhet e izoluar dhe duhet të marrë parasysh pasojat e mundshme për serbët e jugut.

Një folës serb nga Kosova elaboroi disa nga zhvillimet e përgjithshme në lidhje më serbët e jugut. Një pjesë e madhe e popullatës serbe në Kosovë nuk është e informuar pse serbët e jugut po marrin pjesë në procesin politik të Kosovës. “Serbët nuk janë të kënaqur me zhvillimet dhe kjo është arsyeja përse ata vendosën të marrin pjesë në institucione të Kosovës.” Shumica e serbëve në Kosovë jetojnë në jug të lumit Ibër. Ata kanë jetuar në kushte të vështira dhe për këtë arsye ata u angazhuan në procesin politik, theksoi folësi. Ai tha se serbët në veriun e Kosovës nuk i besojnë më askujt, as Prishtinës e as Beogradit, dhe se ata e dijnë “se çfarë nuk duan, por jo edhe çfarë duan.” Ai tha se qeveria e Kosovës po arrin mjaft rezultate të mira duke e pasur parasysh situatën. Ai propozoi që modeli i njejtë i integritit si i serbëve të jugut do të mund të zbatohet edhe për serbët e veriut.

Një pjesëmarrës nga veriu ofroi një listë problemesh të një rëndësie të vecantë për njerëzit në veri. Këto përfshinin zhvillimin ekonomik, papunësinë, identitetin,

kthimin e refugjatëve, kthimin e pronave, personat e zhdukur, mbrojtjen legale, dhe zgjidhjen e rasteve gjyqësore ende të pazgjidhura. Një folës shqiptar theksoi se problemet praktike të veriut janë të njëjta sikur të jugut. Gjyqet nuk funksionojnë siç duhet. Reduktimet e energjisë elektrike, furnizimi me ujë, dhe papunësia janë po aq keq tek shqiptarët. Një folës tjetër tha që të gjitha këto janë çështje të statusit. “Nuk mund të kesh sundim të ligjit në veri pa e zgjidhur statusin, pa u pajtuar së pari se ligjet e kujt duhet të zbatohen këtu.” Ai parashihte që po të mos vepronin në mënyrë të guximshme, veriu i Kosovës do të mbetej një konflikt i ngrirë për vite të tëra. Një pjesëmarrës serb u pajtua se konflikti i ngrirë do të mbetej deri sa Serbia dhe Kosova nuk e dijnë se ku i kanë kufijtë. Ai shtoi se Beogradi nuk e dëshiron tërë Kosovën. “Kur Beogradi thotë edhe Kosovën, edhe Bashkimin Evropian, çfarë në të vërtetë dëshiron të thotë është edhe veriun e Kosovës dhe Bashkimin Evropian.”

Çështja e identitetit është ngritur nga një numër pjesëmarrësish. Një numër i serbëve thonin se termi “kosovar” po ju imponohet. “Unë kam qenë serb për pesëdhjetë vite dhe nuk dëshiroj ta ndërrojë identitetin tim tani.” Por disa folës të tjerë thonin që kosovar nuk do të thotë shqiptar. “As shqiptarët nuk e duan termin.” Është një mbiemër që nënkupton se i takon Kosovës. Thënë ndryshe, do të thotë që je banor i Kosovës.

Prishtina dhe Veriu

Një pjesëmarrës shqiptar nga Kosova kundërshtonte ndryshimin e kufijve apo ndarjen si opsion. Ai bëri thirrje për kompromis. “Marrëveshja e Rambujesë, Plani i Ahtisaarit dhe kushtetuta e Kosovës ishin të gjitha kompromise.” Ai shpjegoi se vetë shqiptarët kishin probleme një kohë që ta kuptojnë nocionin e kompromisit, por tani kanë kuptuar që duhet ta fitojnë besimin e serbëve të veriut dhe duan që së bashku të dalin me zgjidhje të bazuara në kompromis. Ai tha se shqiptarët dhe serbët do të duhej të fokusoheshin në arsyt përse të jetojnë së bashku e jo vetëm në arsyt përse nuk duhet ta bëjnë një gjë të tillë. “Kosova nuk është as vendi i parë e as i fundit që funksionon si vend multietnik. Vetë shteti multietnik është një kompromis.” Ai theksoi se qeveria e Kosovës e ka vullnetin dhe fondet që ta bëjë veriun një pjesë normale dhe prosperuese të Kosovës, por kjo do të mund të arrihej vetëm kur të fillojmë t’i numërojmë mundësitë, dhe jo pamundësitë për bashkëjetesë. Folësi poashtu tha se qeveria e Kosovës ka vullnet të krijojë dialog dhe komunikim me “njerëzit e veriut” por nuk specifikoi se kush do të ishin këta njerëz. Ai megjithatë do të pranonte dialogun me kryetarët e komunave serbe në veri në kapacitetin e tyre personal.

Konflikti qëndron mes Beogradit dhe Prishtinës dhe jo ndërmjet serbëve nga Kosova dhe Prishtina, pohonte një folës nga Kosova. “Serbia po e përdor mospranimin aktiv të Kosovës, duke bërë gjithçka për të shkatërruar procesin shtetndërtues të Kosovës dhe duke bërë jetën e shqiptarëve edhe më të

vështirë.” Ai tha që Kosova dëshiron të jetë një fqinj i mirë, por që Serbia do të duhej të ishte poashtu një fqinj i mirë. Ai u pajtua me disa nga pohimet që politikanët e Kosovës nuk kanë ndryshuar që nga viti 2004, kur trazirat ndëretnike lanë disa të vdekur, por theksoi se as politika e Serbisë ndaj Kosovës nuk ka ndryshuar. “Retorika është e njejtë, sikursë në kohën e Millosheviqit.”

Shqiptarët dhe serbët kanë problem të komunikojnë. Ata komunikojnë përmes mediave dhe kanaleve indirekte. Mirëpo sipas disa folësve, problemet më të cilat ata ballafaqohen kërkojnë ndërveprime të drejpëdrejta dhe intenzive. Ndarja apo shkëmbimi i territoreve do të ishte veprimi i cili do t'ia ruante fytren vetëm Beogradit dhe eksperiencat nga e kaluara tregojnë se zgjidhje të tilla nuk janë të mira për njerëzit, tha një folës shqiptar. Ai e mbrojti planin e Ahtisaarit, duke thënë që ai në fakt ju ofron serbëve të Kosovës një status autonom jo territorial. Së pari, parlamentit i nevojitet mbështetja e dy të tretave të parlamentarëve joshqiptarë për ta ndërruar kushtetuten. “Kjo është arsye përse shqiptarët nuk mund të dominojnë. Jo për shkak se janë njerëz të mirë.” Se dyti, parlamenti nuk mund ta ndërrojë ligjin mbi zgjedhjet pa mbështetjen e dy të tretave të parlamentarëve joshqiptarë. “Këto mekanizma vendimmarrës janë si ato të dy dhomave, sikurse në një federatë.” Së treti, plani i Ahtisaarit lejon që Serbia të transferojë nëpërmjet bankave komerciale fonde pa pasur nevojë të paguajë tatim. Dhe së katërti, plani lejon shtetësi të dyfishtë: serbët mund të kenë dy patentshoferë, dy pasaporta dhe dokumente të tjera. Dhe vetë serbët e Kosovës mund të zgjedhin se cilat dokumenta duan ti përdorin. Ai nxiti serbët e veriut të artikulojnë nevojat dhe frikat e tyre të cilat plani i Ahtisaarit nuk i përfshin. Çfarë vendime dëshirojnë të marrin vetë? Mirëpo konkludoi që shqiptarët nuk do të pranonin një federatë territoriale apo joterritoriale.

Një rrugë përpara? Ndërtimi i besimit

Një numër i folësve, si serbë ashtu edhe shqiptarë thanë se shqiptarët dhe serbët duhet të ndërtojnë një mirëkuptim të përbashkët, të fokusohen në çështje praktike dhe jo në pyetje gjenerike se a do të duhej ta ndajnë Kosovën apo a mund të jetojnë së bashku serbët dhe shqiptarët. Këto pyetje nuk do të duhet të ishin pjesë e debatit për veriun. Integrimi i serbëve në jug të Kosovës do të duhej të shërbente si shembull për t'i bindur serbët e veriut që integrimi është i mundur, që shumica shqiptare nuk mund t'i dominojë institucionet.

Një pjesëmarrës shqiptar propozoi që politikanët do të duhej të fokusoheshin në zhvillimin ekonomik. “Unë jam për një Kosovë të zhvilluar, jo për një Kosovë multi-etnike.” Sa i përket veriut, ai tha këtu nuk bëhet fjalë për paratë. “Nuk është për të konkurruar me Serbinë se kush po ofron më shumë. Veriu ka të bëjë me statusin. Ne nuk mund ti zgjidhim çështjet praktike pa e zgjidhur statusin paraprakisht”.

Një folës serb nga veriu tha që mungesa e besimit të veriut të Kosovës karshi Prishtinës ekziston për shkak se Prishtina nuk ka bërë mjaft për të ndërtuar besimin. Një numër i madh i i rasteve gjyqësore nuk janë zgjidhur. “Shtëpia ime është djegur dhe autorët e krimit ende janë të lirë. Prishtina e dëshiron territorin pa popullsinë.” Një folës shqiptar u përgjigj duke thënë se shtëpitë e qindra mijëra shqiptarëve janë djegur dhe autorët e krimit janë po ashtu ende të lirë. Gjykatat e Kosovës akoma nuk janë operative ashtu siç duhet prandaj është vështirë të dihet së çfarë është e motivuar në baza etnike dhe çfarë vjen si pasojë e performancës së dobët të gjykatave, theksoi ai. Folësi serb tha se nëse ata do të pranonin paratë nga Prishtina, 20 milion euro është shumë jodomethanëse. “Vetëm Universiteti në Mitrovicë i merr 10 milion Euro nga Beogradi.”

Kërkesa për pajtim dhe për konfrontim me të kaluarën ka qenë një temë që është paraqitur gjatë tërë diskutimit. Një zyrtar i një partie serbe tha se serbët dhe shqiptarët duhet ta pranojnë problemin dhe mos të arsyetojnë krimet e bëra në të kaluarën. Folësi tha se këto masa që ndërtojnë besimin sic janë zgjidhja e lëndëve gjyqësore dhe ofrimi i kushteve për kthimin e refugjatëve duhet të ndërmerren menjëherë. Ndërtimi i besimit kërkon më shumë komunikim të drejtpërdrejt. “Vetëm disa njerëz nga të dyja palët kanë mundësinë për të komunikuar drejtpërdrejt me njëri-tjetrin.” Në fund të fundit, sic konkludoi një folës, të dyja palët duhet të heqin dorë nga diçka për të arritur një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët.

Komuniteti ndërkombëtar

Një pjesëmarrës nga Prishtina argumentonte se BE-ja nuk ka një qasje të balancuar: ajo i ofron Serbisë statusin e kandidatit për BE, ndërsa Kosovës vetëm qasje në territorin e saj verior. Një pjesëmarrës tjetër kundërshtoi pohimin që BE-ja ka një qasje të pabalancuar dhe përmendi rezultatet që solli dialogu Beograd-Prishtinë në Bruksel i sponsoruar nga BE-ja, për të dyja palët. “Dialogu theu bllokadën ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve. Shumë besuan se ata do të largohen para se të fillojnë. Rezultatet janë të vogla, por megjithatë ekzistojnë. Në duhet të ndërtojmë mbi to, në vend se ta kritikojmë dhe minojmë dialogun.” Folësi tha se BE-ja së shpejti do të fillojë një dialog për liberalizimin e vizave me Kosovën dhe që poashtu së shpejti do të arrijë marrëveshje rreth emrit me të cilin Kosova do të marrë pjesë në programin evropian.

Anëtarësimi në BE mbetet motivi kryesor për Serbinë dhe Kosovën për të bashkëpunuar. Rruga e integritit të Serbisë në BE është e lidhur drejtpërsëdrejti me Kosovën, tha një folës shqiptar. Ai ua kujtoi serbëve të veriut se ata duhet ta dijnë se mungesa e bashkëpunimit nga ana e tyre do të ketë pasoja negative për integrimin e Serbisë në BE. BE-ja nuk është e njejta sikurse para dy viteve, ndikimi i pesë shteteve që vazhdojnë të refuzojnë ta pranojnë Kosovën, nuk është aq i fuqishëm sikurse para dy vjetëve. “Tani Gjermania luan rolin kyç.” Ai

propozoi që të rritet presioni ndaj Serbisë në mënyrë që të arrihet një përparim, veçanerisht në largimin e barrikadave dhe shpërbërjen e strukturave paralele.

Një pjesëmarrës ndërkombëtar propozoi që të dyja palët do të duhej të fokusoheshin në gjetjen hapave të përkohshme për ta stabilizuar situatën dhe për ta parapërgatitur terrenin për zgjidhje politike për veriun. “Ne nuk mund të injorojmë faktin se Serbia nuk e njeh Kosovën, mirëpo le ta analizojmë situatën dhe të shohim se çfarë mund të bëhet në këto rrethana.” Ai tha se përparimi në një fushë mund të sjellë përparim në një fushë tjetër. “Batica ngrit të gjitha barkat”.

Përfundimi

Përkundër faktit që të dyja palët, si shqiptarët ashtu edhe serbët kryesisht përsëritën qëndrimet e tyre të mirënjohura publike për veriun dhe statusin e Kosovës në përgjithësi, tryeza e rumbullakët në Vjenë prezantoi një numër përfundimesh të rëndësishme dhe tema të reja për diskutim. Ajo poashtu parashtroi një agjendë për diskutime të mëtutjeshme. Takimi paraqiste një mundësi unike për shumë pjesëmarrës që të ulën në tavolinën e njejtë për të parën herë që nga fillimi i vitit 2008, kur Kosova e shpalli pavarësinë.

Duke pasë parasysh këtë, është shumë e qartë që kërkimi për kompromise është në një fazë të hershme.

Pengesa kryesore e diskutimeve të mëtutjeshme produktive që është vënë në pah nga shkëmbimet në Vjenë është mungesa e madhe e besimit dhe niveli i pamjaftueshëm i komunikimit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në përgjithësi e në veçanti ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe përfaqësuesve serbë të veriut të Kosovës. Mosbesimi dhe dyshimi janë gjithmonë të pranishme. Diskutime të mëtutjeshme të tilla sikurse ky i organizuar në Vjenë pa dyshim do të prezantonin palët mes vete më mirë dhe do të kontribuonin në relaksim të mëtejshëm të atmosferës ndërmjet tyre.

Megjithatë, takimi në Vjenë poashtu tregoi se është e mundur të ndërmerren disa hapa që do ta ndërtonin besimin edhe para se të zgjidhet statusi i veriut të Kosovës. Pjesëmarrësit serb, në veri identifikuan çështjet e sigurisë dhe të sundimit të ligjit dhe veçanerisht funksionimin e policisë dhe sistemit gjyqësor, sigurimin e të drejtave të pronave, papunësinë, organizimin e vetëqeverisjes lokale në veri dhe frikën nga humbja e identitetit të tyre serb, si çështje të rëndësishme për të cilat janë të gatshëm të angazhohen në diskutime me homologët e tyre shqiptarë. Këto çështje, megjithëse janë të natyrës së përgjithshme, meritojnë zbrëthim të mëtejshëm nga pjesëmarrësit. Një dialog i propozuar ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe të gjithë faktorëve politik me ndikim do të ishin vendi i duhur për ta bërë këtë. Një diskutim mbi këto çështje

dhe hapa drejt zgjidhjes së tyre do të caktonte zhvillimin e masave të ndërtimit të besimi, që nevojitet aq shumë.

Këto mundësi të prezantuara në tryezën e rrumbullakët në Vjenë, do të duhej të shqyrtoheshin në takime të mëtejme. CIG planifikon ta organizojë një takim të rradhës në fillim të vitit 2012.

TRYEZA E RRUMBULLAKËT NË PRZHNO

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) më 3 dhe 4 mars të vitit 2012 ka organizuar në Przhno të Malit të Zi tryezën e dytë të rrumbullakët për përfaqësuesit e partive politike dhe qeverive të Serbisë e Kosovës. Takimi i parë është mbajtur në Vjenë, në dhjetor të vitit 2011. Pjesëmarrës në këtë tryezë kanë qenë anëtarë të partive politike të Serbisë, si Partia Demokratike, Partia e Rajoneve të Bashkuara të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë, Partia Liberal-Demokrate, Partia Progressive Serbe si dhe anëtarë të partive politike të Kosovës, si Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Partia a Pavarur Liberale, Lista e Bashkuar Serbe, si dhe një numër analistësh nga Beogradi e Prishtina. Në takim kanë qenë të pranishëm edhe diplomatë zviceran dhe të BE-së.

Tryeza e rrumbullakët është financuar nga Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme.

Agjenda e takimit dy ditësh ka përmbytur tri sesione dhe tema rreth bashkëpunimit mes Beogradit e Prishtinës dhe krizës në veri. Pjesëmarrësit kanë diskutuar për komunikimin e tanishëm mes Beogradit e Prishtinës dhe kanë propozuar mënyra të reja për intensifikimin e tij në të gjitha nivelet. Pjesëmarrësit poashtu kanë debatuar për situatën e krijuar në veri të Kosovës. Ata kanë rekomanduar që Prishtina dhe serbët në veri duhet të fillojnë sa më parë që është e mundur një dialog për stabilizimin e situatës dhe zgjidhjen e krizës.

Më poshtë është përmbledhja e diskutimeve në tryezën e rrumbullakët. Për të inkurajuar diskutim të hapur e të sinqertë, komentet e bëra gjatë diskutimeve nuk i janë atribuar folësve dhe CIG kërkon mirëkuptim nga ata komentet e të cilëve nuk janë paraqitur të plota në këtë raport të shkurtër. Pjesëmarrësit në këtë tryezë kanë marrë pjesë në cilësinë personal dhe qëndrimet e tyre nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e organizatave që ata përfaqësojnë. Pjesëmarrësit nuk e kanë parë raportin dhe së këndejmi CIG merr përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

Beogradi, Prishtina dhe veriu i Kosovës

Hapat për zgjidhjen e krizës në veri; zgjedhjet serbe në Kosovë; ndikimi i referendumit në veri; ndikimi i dialogut të vazhdueshëm Prishtinë-Beograd të sponsorizuar nga BE-ja

Një numër pjesëmarrësish kanë identifikuar katër akterë kryesorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes rreth veriut të Kosovës: Beogradin, Prishtinën, komunitetin ndërkombëtar dhe serbët në veri. Serbët në veri janë vetëorganizuar përmes

aksioneve si ato për ngritjen e barrikadave “për tu mbrojtur nga ndonjë intervenim eventual i rradhës nga policia e Kosovës”, ka thënë një pjesëmarrës serb, dhe ka shtuar se ata poashtu kanë organizuar referendumin i cili ka treguar se shumica absolute është kundër integritit në institucionet e Kosovës. “Beogradi ka qenë kundër referendumit por ai nuk mund ta injorojë rezultatin”, ka shtuar ky folës. Ai poashtu ka thënë se do të ishte mirë sikur Beogradi të formonte një qeveri të fortë pas zgjedhjeve në pranverë, por ka tërhequr vërejtjen se formimi i qeverisë së re mund të zgjasë me muaj, dhe sipas të gjitha gjasave dialogu me Prishtinës do të “ngrihet” për një kohë. Ai i ka bërë thirrje Prishtinës që të japë garanca se nuk do të ndërmarrë “veprime të njëanshme” duke thënë se një veprim i tillë do të ndihmonte në ndërtimin e besimit mes serbëve e shqiptarëve. Sipas këtij folësi, Prishtinës nuk mund ti besohet. Ai ka shtuar se Prishtina mund të intervenojë në veri për të larguar vëmendjen nga problemet reale me të cilat Kosova është duke u ballafaquar për momentin.

Sipas një folësi shqiptar nga Kosova, mosmarrëveshja është duke vazhduar për një kohë shumë të gjatë dhe Beogradi e Prishtina duhet t'i adresojnë të gjitha çështjet pa u vonuar. Vonesa në zgjidhjen e problemeve dhe mbajtja e status quo-së krijojnë mjedis në të cilin zgjidhja e problemeve është e pamundur. Ai ka shtuar se trazirat e vitit 2004 kanë treguar se status quo-ja nuk është zgjidhje e qëndrueshme. Pikërisht për këto arsye, status quo-ja në veri nuk do të duhej të mbështetej. Ai ka thënë se edhe pse plani i Ahtisaarit i jep Kosovës pavarësinë, i njëjti poashtu ofron garanci të plota për minoritetet dhe serbët duhet ti shfrytëzojnë këto të drejta. Ky folës ka shtuar se është shkurt-pamëse të thuhet se të gjitha strukturat paralele serbe në veri të Kosovës janë kriminale. Sipas tij, Prishtina duhet të provojë të komunikojmë me ata të cilët janë të gatshëm të komunikojnë. Veriu ka nevojë për demokraci dhe zhvillim ekonomik por brenga kryesore do të duhej të ishte vendosja e rendit dhe ligjit. Ky folës ka thënë se policia duhet të jetë nën një komandë kurse oficerët e policisë duhet “ta luftojnë krimin e jo aktivistët politik”. Duke folur për procesin e integritit në BE, ky diskutues ka thënë se të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Serbinë e Kosovën do të duhej t'i bashkoheshin BE-së si grup. “Një gjë e tillë do të shërbente si nxitje për të bashkëpunuar me njëri tjetrin duke e ditur se të gjithë janë në barkën e njëjtë”, ka përfunuar ky diskutues.

“Unë kam qenë për ndarjen e kompetencave, dhe jo edhe aq për ndarjen territoriale”, ka thënë një pjesëmarrës serb duke folur për zgjidhjet e mundshme për veriun. Ai ka thënë se një model i ngjashëm me atë të Bosnjës do të mund të ishte i dobishëm në këtë rast: një parlament i Kosovës me dy dhoma, në mënyrë që të dyja anët ta bllokoni njëra tjetrën në rast nevojë dhe të ofrojnë mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Megjithatë, ai ka thënë se tashmë kjo nuk mund të konsiderohet si zgjidhje, por ka shtuar se vetëm decentralizimi nuk është i mjaftueshëm. Ai ka paraqitur gjashtë pika si udhërrëfyes për zgjidhjen e

problemit të veriut: 1) Ekzistojnë negociata mes Prishtinës e Beogradit dhe ato kanë prodhuar disa rezultate; këto bisedime duhet të vazhdojnë; 2) Përmirësimi i marrdhënieve mes Prishtinës e Beogradit përmes një angazhimi më të madh të OJQ-ve; 3) Vendosja e e komunikimit mes partive shqiptare e serbe në Kosovë e Serbi përmes anëtarësimit të tyre në organizatat ndërkombëtare partiake; 4) Vendosja e bashkëpunimit mes ministrive në Kosovë e Serbi përgjegjëse për implementimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel; 5) Organizimi i takimeve formale mes zyrtarëve të Beogradit e Prishtinës; dhe 6) Promovimi i një qasjeje të përbashkët në raport me BE-në. Ky diskutues ka konkluduar se kriza në veri do të zgjidhet vetvetiu nëse të gjitha këto gjashtë pika implementohen.

Një tjetër diskutues serb u ka bërë thirrje të gjithë akterëve që të jenë realistë. “Ne duhet të jemi realistë, përndryshe [ne] nuk do të jemi në gjendje të ndërtojmë kurrfarë besimi”. Realiteti është se serbët në veri nuk janë organizuar politikisht vetvetiu. Beogradi u ka ndihmuar, ka theksuar folësi. Ata që janë në pushtet duhet të tregojnë se si kanë ndodhur të gjitha këto. Beogradi nuk e pranon planin e Ahtisarit kurse Prishtina e aplaudon atë. Ky folës ka theksuar se Beogradi nuk është i sinqertë me serbët në veri. “Plani i Ahtisarit është i vetmi dokument, nëse nuk e pranojmë atë, atëherë çfarë? Nuk është dokument i përsosur por megjithatë është dokumenti i vetëm”. Ai u ka bërë thirrje zyrtarëve të Beogradit që të jenë më të sinqertë dhe realistë. Ky folës poashtu ka adresuar çështjen e krimit në veri. Ai ka thënë se edhe Prishtina e edhe Beogradi janë përgjegjëse. Ai ka theksuar se si Beogradi ashtu edhe Prishtina do të duhej të jepnin më shumë informata në lidhje me shumën e fondeve që i jipen veriut dhe të kërkojnë përgjegjësi për keqpërdorimin e tyre. Ky folës ka theksuar se OJQ-të do të mund të bënin më shumë për të përmirësuar marrdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve por së pari ato duhet të distancohen nga politika. “Shumë OJQ e përkrahin qeverinë dhe thonë të njejtën që e thotë edhe qeveria. OJQ-të duhet të luajnë një rol më kritik. Ato poashtu duhet të japin llogari për veprimet e tyre”. Një pjesëmarrës shqiptar është pajtuar se shoqëria civile duhet të kërkojë qeverisje më të mirë si në Kosovë ashtu dhe në Serbi, në nivelin lokal dhe atë qendror.

“Ne nuk do të lejojmë zgjedhjet lokale serbe në Kosovë. Beogradi mundet ose të caktojë zyrtarë lokal apo të përgatisë terrenin për zgjedhjet lokale të Kosovës në veri”, ka thënë një pjesëmarrës shqiptar. Beogradit i lejohej të financojë projektet në veri por komuniteti ndërkombëtar duhet ta mbikëqyr procesin. Ai ka thënë se Prishtina duhet të rrisë përpjekjet e saja për të promovuar planin e Ahtisarit në veri. Ky folës ka theksuar se zgjedhjet gjithmonë i ndërpresin proceset. Beogradi është duke u përgatitur për zgjedhjet në muajin maj dhe do t’i duhet kohë për ta formuar qeverinë. Më vonë edhe Prishtina mund të ketë zgjedhje. Ai ka thënë se Prishtinës dhe Beogradit do të duhet t’u jepet një shansë e barabartë për të punuar brenda kornizës së BE-së. “Karrotat duhet tu ofrohen secilit”. Ky folës ka

shtuar se çështja e veriut mund të zgjidhet suksesshëm vetëm nëse Prishtina dhe Beogradi lëvizin drejt BE-së në të njëjtën kohë. “Ne duhet të planifikojmë një proces të kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës për veriun. Kjo do të conte deri te zhvillimi i një vetëqeverisjeje të qëndrueshme lokale. Çaktimi i zyrtarëve lokal në veri do të mund të ndihmonte gjatë periudhës kalimtare, si përgatitje para zgjedhjeve. Prishtina nuk duhet të detyrohet ta prodhojë një pako speciale për veriun. Nëse një gjë e tillë është e nevojshme, atëherë ajo duhet të përgatitet nga komuniteti ndërkombëtar”.

Sipas njërit folës shqiptar, mungon sinqeriteti i Beogradit karshi serbëve në Kosovë. “Për Beogradin Kosova është një problem elektoral, por problem real për serbët e Kosovës”. Ai ka thënë se ata duhet të largohen nga kjo situatë ku shikohet se kush do t’i fitojë zgjedhjet në Serbi dhe mos ta vonojnë procesin. Ai ka thënë se çdokush i frikësohet ndryshimit sepse kjo do të thoshte humbje e disa përfitimeve për grupe të caktuara. Ky folës ka kritikuar Beogradin për përdorim të standardeve të dyfishta. “Beogradi dëshiron status special për veriun, por thotë se asnjëherë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës”. Një pjesëmarrës tjetër ka thënë se kriza në veri nuk ka të bëjë me frikën por me ambiciet. Edhe pse ekziston një mundësi për zgjidhjen e problemit si nga Prishtina ashtu edhe nga Beogradi, kjo çështje mbetet e rrethuar nga paqartësi, por të dyja palët duhet të hyjnë në shkëmbim të hapur dhe të sinqertë. Ai ka thënë se të dyja palët duhet të japin më shumë mesazhe positive sesa kërcënime.

Një folës tjetër ka thënë se zgjidhja duhet të planifikohet së bashku. “Neve na duhet qartësi dhe pastaj do t’i përshtatemi mjedisit”. Shqiptarët dhe serbët i kanë recikluar argumentet e njehta tashmë dhjetë vite, përderisa bota ka ndryshuar. Masat për ndërtimin e besimit mes Prishtinës dhe veriut, dhe mes vetë serbëve janë mëse të nevojshme. Ai ka thënë se thirrja e presidentit Tadic për “rajonin e quajtur Kosovë veriore nuk është hap i mirë”. Frika e serbëve të Kosovës nuk është e bazuar në fakte. Ky folës ka shtuar pyetjen se “pse serbët e Kosovës në veri mendojnë se në rast të integritimit në institucionet e Kosovës, shqiptarët do t’i largojnë ata?” Ai ka theksuar se ka qenë mëse e qartë se Serbia ka mbështetur referendumin në veri me vetë faktin që nuk ka bërë asgjë për ta ndaluar ate.

“Ne nuk jemi vendimmarrës por ne mund ti promovojmë idetë tona tek ata të cilët marrin vendime”, ka thënë një diskutues shqiptar. Koha humbet nga zgjedhjet e njëpasnjëshme, gjë që nuk është në pajtim me nevojat e qytetarëve. Pyetja në referendumin e mbajtur në veri do të duhej të ishte nëse qytetarët atje duan të jetojnë njësoj edhe për dhjetë vitet e ardhshme. Ai ka thënë se shqiptarët e Lugjinës së Preshevës kanë mbajtur një referendum para dhjetë vitesh dhe ka pyetur se çfare ka qenë rezultati duke aluduar se nuk ka pasur kurrfarë ndikimi. “Nëse u japim njerëzve mundësinë për të votuar, shqiptarët

do të votonin për bashkimin me Shqipërinë, e serbët për bashkim me Serbinë”. Është mëse e nevojshme të qartësohet koncepti i perspektivave dhe të mos mbahen njerëzit nën iluzionin se do t’i bashkohen Serbisë në dhjetë vitet e ardhshme. “Shumë prej nesh nuk duan t’i humbim edhe dhjetë vite tjera.” Ai ka theksuar se dialogu mes Beogradit e Prishtinës ka qenë relativisht i suksesshëm sepse perspektiva e integritimit evropian u është prezantuar të dyja shteteve. Ai ka inkurajuar komunitetin ndërkombëtar që të bëjë më shumë në këtë drejtim. Një pjesëmarrës tjetër ka kërkuar nga BE-ja që të zhvillojë një udhërrëfyes të qartë me hapa të qartë që duhen ndërmarrë nga secila palë dhe me një kushtëzim dinamik. Sipas këtij pjesëmarrësi, kriteri numër një do të duhej të ishte që Beogradi e Prishtina të ulen së bashku dhe të fillojnë të pajtohen për çështje të hapura.

Në tryezë është diskutuar edhe çështja e zgjedhjeve të ardhshme serbe në Kosovë. Pasi që ka theksuar se Beogradi së shpejti do të tregojë nëse do ti mbajë zgjedhjet në Kosovë, një folës serb ka thënë se Beogradi nuk është i sigurt në politikën e tij ndaj Kosovës. Beogradi duhet të jetë më transparent dhe më i sigurt rreth asaj se cka ai don që serbët e Kosovës të bëjnë. Edhe Prishtina duhet të jetë më e hapur. “Ne dijmë për ultimatumin gjerman drejtuar institucioneve serbe në veri por cka do të ndodhë me mijëra njerëz të cilët punojnë në këto institucione?” Ky folës ka thënë se kjo çështje duhet të zgjidhet duke marrë parasysh interesin e njerëzve në veri. Një tjetër pjesëmarrës ka thënë se pjesa më e madhe e njerëzve që janë momentalisht të punësuar në administratën lokale në veri do të punësoheshin në çfarëdo qeverie komunale në të ardhmen. Një tjetër pjesëmarrës ka thënë se mesazhi i referendumit nuk ka qenë i drejtuar vetëm drejt Prishtinës dhe kundër institucioneve të saj por edhe drejt Beogradit duke shprehur dëshirën për tu bërë pjesë e procesit vendimmarrës atje. Ky folës ka kërkuar më shumë transparencë. “Na është thënë se dialogu mes Beogradit e Prishtinës është teknik. Ka dalë se ka qenë politik”. Një folës nga Beogradi ka thënë se nuk pritet të ketë shumë përparim në këtë drejtim deri në fund të vitit për shkak të zgjedhjeve. “Vendimet e mëdha nuk merren gjatë fushatave elektorale”.

Sipas një pjesëmarrësi shqiptar, Prishtina ka ndërmarrë një numër të vendimeve që nuk janë pritur edhe aq mirë sikurse marrëveshja për përfaqësimin rajonal si dhe ligjet për Hocën e Madhe dhe qendrën historike të Prizrenit. Ai ka theksuar se rendi shtetëror i Kosovës mund të minohet nëse veriut i jipen shumë kompetenca. Beogradit i është kërkuar ta ndalojë financimin e strukturave paralele kurse Prishtinës i është kërkuar të jetë kreative. Por Prishtinës është duke iu ngushtuar hapësira manovruese. Ky folës ka thënë se përderisa Prishtina detyrohet ta implementojë planin e Ahtisarit të plotë në jug, komuniteti ndërkombëtar nuk është duke i ndihmuar Prishtinës ta implementojë të njëjtin në veri. Kjo është më së shumti që qeveria e Kosovës mund të bëjë. Ajo

funksionon falë votave të garantuara të komuniteteve minoritare. Ky folës ka theksuar se partitë opozitare kanë fituar më shumë vota shqiptare në zgjedhjet e fundit parlamentare, apo në përgjithësi më shumë vota sesa partitë që janë pjesë e qeverisë. Një tjetër folës ka thënë se qeveria e Kosovës ka plan për veriun: planin e Ahtisarit. Ai ka pyetur nëse serbët dhe Beogradi kanë ndonjë plan. Ai poashtu ka shtuar se Prishtina nuk e ka të qartë se me kë duhet të flasë në lidhje me veriun: me serbët në veri apo me Beogradin.

Prishtina dhe serbët në veri

Vendosja e besimit, komunikimit dhe bashkëpunimit përbrenda rajonit të Mitrovicës

Si vazhdim i perfundimeve të nxjerra në tryezën e rumbullakët të Vjenës, pjesëmarrësit kanë diskutuar mundësinë e inicimit të komunikimit mes Prishtinës dhe serbëve të veriut. Një numër përfaqësuesish nga Kosova u kanë bërë thirrje publike serbëve në veri ta fillojnë komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës duke përfshirë vizita në ministritë e qeverisë në Prishtinë. Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se hap i parë për serbët në veri mund të jetë dialogu me serbët në qeverinë e Kosovës dhe rreth përvojës së tyre të integritimit. Një folës ka thënë se referendumi në veri e ka komplikuar situatën. “Referendumi mund të mos ketë pasoja legale por do të ketë pasoja politike”. Ai ka shtuar se Beogradi nuk i kontrollon serbët në veri në mënyrë te drejtpërdrejt por i financon ato. Ai ka theksuar se do të ishte mire që kryetarët serbë të komunave në veri të uleshin dhe të dilnin me një strategji të përbashkët, edhe pse për momentin, kjo është dicka shumë e vështirë e ndoshta edhe e pamundur për tu arritur. Disa serbë në veri mbështesin angazhimin dhe janë duke bërë hapa të caktuar pozitiv por pranojnë se tjerët të cilët janë kundër një gjëje të tillë janë në kontroll të situatës dhe marrin vendimet përfundimtare rreth këtyre çështjeve.

Sipas një pjesëmarrësi, ekziston një numër i madh i serbëve të cilët janë të gatshëm të marrin pjesë në institucionet e Kosovës por janë të frikësuar, dhe ka shtuar se momentalisht janë rreth “8,000 aplikacione që presin miratim për marrjen e leternjoftimeve të Kosovës dhe rreth 2,000 njerëz nga veriu i Kosovës janë për momentin në listat e pagave të qeverisë së Kosovës”. Ky folës poashtu ka thënë se qeveria e Kosovës është e gatshme të investojë në veri por serbët nuk i pranojnë fondet e qeverisë së Kosovës. Një numër i projekteve tashmë janë duke u implementuar, sic janë projekti i mirëmbajtjes së vazrrezave dhe ai i instalimit të dritave ndricuese në afërsi të kishave. Qeveria ka shpenzuar rreth gjysëm milioni euro në katër projekte në vitin 2011. Projekt-propozimet kanë ardhur nga serbët lokal. Ky folës ka thënë se jo të gjitha strukturat paralele janë kriminale apo jolegale dhe ka shtuar se

shëndetësia e financuar nga Serbia dhe shërbimet edukative duhet të mbeten edhe më tej.

Një folës i afërt me strukturat serbe në veri ka thënë se ata poashtu e mbështesin zgjidhjen e krizës përmes mjeteve paqësore, por ai ka shtuar se serbët në veri janë duke i ikur komunikimit me Prishtinën sepse Prishtina thotë se ata janë kriminelë e të korruptuar, përfshirë edhe kryetarët e komunave. Ai ka thënë se EULEX-i duhet t'i trajtojë të dyja komunitetet në mënyrë të barabartë. “Tani për tani ai është në anën e shqiptarëve”. Ai ka shpjeguar se serbët në veri nuk mund të diskutojnë planin e Ahtisarit për aq sa qeveria e Serbisë nuk e njeh atë. “Presidenti Tadic ka thënë se në qoftëse plan i Ahtisarit do të implementohej, serbët në Kosovë do të zhdukeshin”. Ky folës ka propozuar që çështja e personave të zhvendosur brenda Kosovës dhe refugjatëve të jenë temat e para për diskutime eventuale mes Prishtinës dhe serbëve në veri. Ai poashtu ka kërkuar nga Prishtina që të garantojë se nuk do t'i kthehet dhunës për ti zgjidhur mosmarrëveshjet. Ai ka pranuar se disa serbë marrin pensione dhe letërnjoftime nga Prishtina, por ka thënë se edhe shqiptarët e kanë bërë të njejtën gjë gjatë viteve të 90-ta. Disa folës shqiptarë kanë thënë se në vitet e 90-ta shqiptarët nuk kanë pasur dokumenta alternative. Serbët kanë këtë mundësi”. Në lidhje me zgjedhjet lokale serbe, ky folës ka thënë se ato do të mbahen edhe nëse janë kundër rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara. “Shqiptarët e kanë shkelur rezolutën 1244 të parët. Ata kanë deklaruar pavarësinë dhe kanë organizuar zgjedhje të pavarrura. Sipas rezolutës 1244, vetëm UNMIK-u ka të drejtë të organizojë zgjedhje”. Ky folës ka thënë se çështjet e mëdha duhet të diskutohen në nivele më të larta, përkatësisht me autoritetet në Beograd. “Ne mund të flasim për problemet ditore me të cilat ballafaqohen qytetarët sic janë mbledhja e mbeturinave, furnizimi me ujë, por jo edhe për çështjet shtetërore.

Një folës shqiptar ka thënë se serbët e Kosovës në veri nuk mund të thonë se nuk u janë ofruar të drejtat. “Ata i refuzojnë ato”. Ai ka thënë se atyre që jetojnë në veri duhet tu jepen më shumë informata rreth asaj që ndodhë në pjesën tjetër të Kosovës. Televizioni i Kosovës duhet të jetë i pranishëm në veri ashtu sic janë televizionet serbe në jug. Ai ka theksuar se plan i Ahtisarit duhet tu shpjegohet njerëzve. “Serbët në veri duhet të na tregojnë se çfarë nuk ofron plan i Ahtisarit”. Folësi është pajtuar se autoritetet lokale në veri nuk kanë kompetenca për të diskutuar çështje të mëdha politike. Ai ka thënë se do të ishte shumë e vështirë të ndërtohet besimi mes komuniteteve marrë parasysh që të rinjtë serbë e shqiptarë nuk kanë komunikuar mes vete për më shumë se njëzet vite. Ai ka theksuar se komunikimi duhet të vendoset edhe mes grupeve më pak të politizuara sic janë profesionistët në fushën e edukimit dhe shëndetësisë.

Një pjesëmarrës serb ka thënë se ka qene e dobishme vendosja e sërishme e kontaktit me ish-kolegët, dhe ka sugjeruar që ata vetë duhet të inicojnë

diskutime joformale. Ajo ka theksuar se autoritetet e Beogradit duhet t'i thërrasin përfaqësuesit e serbëve të Kosovës në Beograd apo të vijnë vetë në Kosovë the "të na pyesin neve se cka duam, cka na duhet dhe se si i shohim ne zgjidhjet e problemeve të mëdha". Megjithate, një tjetër folës ka thënë se cka mendojnë qytetarët në veri është jorelevante për vendimmarrësit në Beograd e Prishtinë. Ai ka thënë se veriu është problem i të gjithëve. Ai ka propozuar që së pari të adresohen problemet praktike, sic është papunësia. Sa i përket çështjes së të kthyerve, ky folës ka thënë se fatkeqësisht ky process ka përfunduar. "Këta njerëz nuk do të kthehen kurrë. Ata kanë ndërtuar jetën e tyre diku tjetër."

Gjatë diskutimeve është hapur edhe tema e identitetit. Një pjesëmarrës serb ka thënë së serbët në veri nuk do të marrin letërnjoftimet dhe dokumentet tjera të Kosovës në të cilat shkruan se ata janë "kosovarë". Një tjetër pjesëmarrës ka theksuar se çështja e identitetit është problem për të gjithë. "Nëse as shqiptarët nuk mund të binden se janë kosovarë, si mund të binden serbët?" Në përfundim, ky pjesëmarrës ka theksuar se implementimi i marrëveshjeve është kyç dhe se ai nuk pret që çështja e veriut të jetë teme diskutimi para vitit 2013.

Përfundimet dhe rekomandimet

Një numër i përfundimeve dhe rekomandimeve kanë dalë nga tryeza e rrumbullakët. Këto kanë dalë nga individë apo grupe të individëve dhe nuk janë bazuar në konsensus.

- Prishtina duhet ta bëjë të qartë se dëshiron të ketë një kanal të hapur të komunikimit me serbët në veri duke përfshirë edhe ata që udhëheqin institucionet paralele atje. Tani që Prishtina pranohet si bashkëbisedues nga Beogradi, ajo do të duhej të ishte e pranueshme edhe për serbët e veriut.
- Beogradi do të ketë një qeveri të re dhe sipas të gjitha gjasave edhe një politikë të re. Nëse politika karshi Kosovës do të ndryshojë, mbetet të shihet. Një qeveri me mbështetje të fuqishme parlamentare mund të merret në mënyrë më efektive me çështjet e veriut.
- Një dialog mes Prishtinës e Beogradit është i dëshirueshëm. Do të jetë vështirë të arrihet një zgjidhje e qëndrueshme pa prezencën e Beogradit në këtë dialog.
- Marrëveshjet e arritura në Bruksel duhet të implementohen të plotë dhe në kohë.
- Barrikatat duhet të largohen dhe duhet të rivendoset liria e lëvizjes përbrenda gjithë Kosovës, në mënyrë që shqiptarët të udhëtojnë në veri dhe serbët të udhëtojnë në jug.
- Terreni duhet të përgatitet për mbajtjen e zgjedhjeve të Kosovës në veri.

- Beogradi nuk duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës, por do të duhej ta pranonte Kosovën si një njësi të vetme territoriale dhe të ndalej së financuari strukturat paralele në territorin e Kosovës.
- Të gjitha palët duhet të bejnë përpjekje për përmirësimin e sigurisë dhe të distancohen nga veprime që cojnë drejt dhunës gjatë kohës sa është duke u përgatitur dialogu.
- Beogradi, Prishtina dhe serbët e Kosovës duhet të kuptojnë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës apo shkëmbim terrioresh.
- Besimi arrihet përmes rezultateve. Serbët në veri të Mitrovicës duhet të flasin me shqiptarët në jug të Mitrovicës. Dy kryetarët e komunave duhet së pari të ulen së bashku e pastaj të fillojë bashkëpunimi mes ekspertëve të të dy komunave për zgjidhjen e problemeve (mbledhja e mbeturinave, furnizimi me uje, ngrohja, energjia elektrike etj). Më vonë, takime të tilla do të mund të mbaheshin edhe me kryetarë tjerë të veriut. Kryetarët e katër komunave serbe në veri, në të ardhmen do të mund të uleshin me kryetarin e Mitrovicës dhe komunitat tjera fqinje dhe të vendosnin një plan të rregullt takimesh, duke organizuar takime cdo javë.
- Strukturat e sigurisë dhe të intelgjencës të Serbisë duhet të largohen nga veriu. Këto struktura janë pengesë për implementimin e marrëveshjeve dhe burimi kryesor i tensioneve në veri.
- Serbët në veri kanë problem të komunikimit me Beogradin dhe me serbët në jug.
- Serbët në veri duhet të dijnë më shumë për planin e Ahtisarit për tu siguruar që qëndrimi i tyre kundër planit të Ahtisaarit është mirë i informuar.
- Beogradi duhet të jetë transparent dhe ti bëjë të ditur detajet e marrëveshjeve të arritura me Prishtinën dhe marrëveshjet joformale me BE-në dhe premtimet e bëra BE-së.
- Të gjitha palët duhet ta zbusin retorikën. Nuk mund të ketë dialog domethënës nëse njerëzit dërgojnë mesazhe agresive.
- Të ndërmerren masa për ndërtimin e besimit: vlerësimin e marrëveshjeve; qartësimin e akuzave kriminale; vendosjen e një sistemi gjyqësor të pastër dhe transparent në veri; Policia e Kosovës duhet të profesionalizohet e reformohet, ndoshta përmes inkuadrimit të serbëve në njësitet speciale të policisë së Kosovës; besimi në KFOR-in dhe EULEX-in duhet të përmirësohet; të rritet bashkëpunimi i policisë me qytetarët.

PËRFUNDIMET E PËRGJITHSHME

Kërkimi për gjetjen e kompromisit dhe për zgjidhje të pranueshme për veriun e Kosovës është në fazën fillëstare. Palët janë shumë larg nga njëra tjetra. Megjithate, një gjë ka qenë e qartë për pjesëmarrësit në Vjenë dhe Przhno: problem i veriut është problem politik dhe duhet të zgjidhet me mjete politike.

Parakushti kryesor për fillimin e një procesi të tillë është përmirësimi i sigurisë në veri. Të gjitha palët duhet të kuptojnë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës apo shkëmbim të territoreve. Të gjitha barrikatad e mbetura atje duhet të largohen dhe liria e lëvizjes duhet të vendoset dhe tu garantohet të gjithëve. Udhëheqësit politik dhe mediat duhet ta zbusin retorikën. Nuk mund të ketë një dialog kuptimplotë përderisa të ketë shkëmbim të gjuhës agresive.

Vendosja e komukimit dhe besimit mes palëve është kryciale. Hapësira mes serbëve dhe shqiptarëve, mosbesimi i dyanshëm si dhe mosbesimi ndaj njëri tjetrit janë shumë të mëdha. Diskutimet e mëtutjeshme të këtij lloji të organizuar nga CIG do të ishin një kontribut serioz për normalizimin e marrëdhënieve.

Dialogu duhet të organizohet në disa nivele.

Dialogu rreth çështjeve praktike mes përfaqësuesve politik të jugut dhe veriut të Mitrovicës jo vetëm që do të vendoste një pikë permanente të kontaktit për zyrtarët lokal por poashtu do të mundësonte zgjidhjen e shume çështjeve të jetës së përditshme përmes të cilave mund të arrihet besimi.

Cfarëdo zgjidhje kërkon dialog mes udhëheqësve politik të serbëve në veri dhe udhëheqësve të institucioneve të Kosovës. Prishtina duhet ta bëjë të qartë se dëshiron ta ketë një kanal të hapur të komunikimit me të gjithë serbët në veri duke përfshirë edhe ata që janë zgjedhur nga komuniteti Serb për ti përfaqësuar ata. Këta politikanë përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të spektrit politik në veri dhe ndikojnë në qytetarët atje. Ata të cilët nuk kanë bërë krime dhe dëshirojnë të mbesin të angazhuar në politikë duhet të kenë një të ardhme politike brenda sistemit politik të Kosovës.

Politikanët në veri duhet ta pranojnë Prishtinën si palë të barabartë në negociata. Tani që Prishtina është pranuar si bashkëbiseduese nga Beogradi, ajo duhet të jetë e pranueshme për serbët në veri.

Megjithate, pa marrë parasysh madhësinë e krizës në veri, zgjidhja e saj është e pamundur pa angazhimin e Prishtinës dhe Beogradit, pa dialogun bilateral politik, dhe pa asistencën e vazhdueshme të komunitetit ndërkombëtar.

Një numër i hapave për ndërtimin e besimit janë të mundshëm edhe para arritjes së zgjidhjes së krizës në veri të Kosovës. Pjesëmarrësit kanë identifikuar

cështjet e sigurisë dhe të sundimit të ligjit, me theks të vecantë funksionimin e policisë dhe sistemit gjyqësor, sigurimin e të drejtave pronësore, papunësinë, organizimin e vetëqeverisjes lokale në veri dhe frikën nga humbja e identitetit serb, si çështje të rëndësishme për të cilat ata janë të gatshëm të hyjnë në diskutime me palën shqiptare. Këto çështje, edhe pse të përgjithshme, meritojnë kërkim të mëtutjeshëm. Dialogu në mes institucioneve të Kosovës dhe akterëve politik me ndikim në veri do të ishte një fillim dhe vend i mirë për këte.

U POTRAZI ZA REŠENJIMA ZA SEVER KOSOVA

Predgovor i izrazi zahvalnosti

Savez za inkluzivno upravljanje (CIG) je posvećen pitanjima Kosova još od početka svog rada 2010. godine. Od juna 2010., održali smo program srpsko-srpskog dijaloga dovodeći za sto različite, često suprotstavljene, političke frakcije Srba na Kosovu i zvaničnike iz Beograda sa ciljem unapređivanja komunikacije između ovih grupa i poboljšanja praktičnih politika koje su usmerene ka Srbima sa Kosova. U vezi sa tim, učesnici programa su proizveli političke preporuke, a CIG ih formulisao u maju 2011. Dokument *Političke preporuke o prilagođavanju Srba na Kosovu* su dostupne na našoj internet stranici www.cigonline.net. Od 2011., albanski zvaničnici Vlade i Skupštine Kosova, kao i predstavnici civilnog društva takođe aktivno učestvuju u okviru novog CIG programa, na taj način šireći diskusiju i obuhvatajući pitanja vezana za odnose između Srba sa Kosova i kosovskih vladinih institucija, a naročito između Srba sa severa i Prištine.

Ovi programi su svesrdno podržani od strane Saveznog ministarstva spoljnih poslova Švajcarske.

Dve diskusije koje su predmet ove publikacije su održane u decembru 2011. u Beču, u Austriji, i u martu 2012. u Pržnom, na jadranskoj obali Crne Gore. CIG je okupio političke zvaničnike, analitičare i predstavnike civilnog društva sa Kosova i iz Srbije, kao i evropske i američke diplomate kako bi zajednički diskutovali u neutralnoj i neformalnoj atmosferi.

Ove diskusije su za mnoge od učesnika bila njihova prva prilika za suočavanje licem u lice, još od kosovske deklaracije nezavisnosti u februaru 2008.

Ideja za ove sastanke je potekla od zasebnih razgovora sa političarima i analitičarima na Kosovu i Srbiji, tokom leta i jeseni 2011.godine. Njihova mišljenja pomogla su nam u sastavljanju nacрта agende za ove diskusije.

Cilj ovih CIG sastanaka bio je da se kreira mogućnost za lidere sa Kosova i Srbije da pronađu rešenja za veoma napetu situaciju na severu Kosova koja je započela u leto 2011., da se odrede neke kratkoročni i dugoročni koraci koji bi mogli da se preduzmu u izgradnji puzdanja i poverenja između dve strane, kao i da se podstakne razmena pogleda o ponovnom oživljavanju srpsko-albanskog dijaloga, i unutar i van Kosova, a naročito između Srba na severu i kosovskih vladinih institucija.

Pitanje severa Kosova je danas jedno od najkomplikovanijih pitanja Jugoistočne Evrope i ono pretili da destabilizuje ne samo Kosovo i Srbiju već i države iz okruženja. Razrešenje ovog problema će direktno uticati na srpski i kosovski glavni spoljnopolitički cilj - njihovo eventualno pridruživanje Evropskoj Uniji.

S jedne strane, sastanci su potvrdili mnoštvo unapred određenih i zacrtanih ideja o ekstremno teškom suočavanju sa problemom severa, kao i činjenici da će razrešenje ovog problema zahtevati dug i mukotrpan proces. S druge strane, iz ovih razgovora je takođe bilo jasno da je određen broj mera izgradnje poverenja moguć i da bi one trebale biti primenjene bez odlaganja. Nedavni izlivi nasilja na severu svedoče o važnosti ovakvih mera, čiji se navodi mogu pročitati u nastavku teksta.

Razgovori su takođe doveli do izražaja veliku zabrinutost za Srbe sa juga i dali do jasnog znanja da pitanja severa ne mogu da se posmatraju izolovano, već da se smatraju delom sveukupnog pitanja prilagođavanja Srba koji žive na Kosovu, i na severu i na jugu.

Uprkos njihovim različitim stavovima, sama činjenica da su se učesnici zajedno okupili i dogovorili da pronađu uzajamno prihvatljive načine za razrešavanje neodrživog statusa kvo na severu nam je dalo nadu da ovaj veliki problem može da se reši na miran način. Prema mišljenju učesnika, to će zahtevati stalan dijalog, uzdržanost i strpljiv rad na poboljšanju svakodnevnih uslova onih koji žive na severu. Da li će se to ostvariti zavisi od političkih lidera obe strane.

Problemi Srba i Albanaca su isprepletani i biće potrebno dugo vremena kako bi se konačno razdvojili, a srpsko-albanski spor razrešio. Mi se nadamo da će diskusije koje organizuje CIG pomoći da se taj momenat brže desi.

Mi smo zahvalni učesnicima na njihovom doprinosu, disciplini, strpljenju i poštovanju jedni drugih, što je bilo ključno za uspeh ovakvog poduhvata. CIG se nada da će ovaj dijalog da održi i planira da uskoro organizuje buduće susrete.

Mi smo vrlo zahvalni našim kolegama i prijateljima iz Saveznog ministarstva spoljnih poslova Švajcarske, a naročito Karolin Tiso, Norbertu Rjutšeu i Rolandu Salvisbergu na njihovoj saradnji i svesrdnoj podršci aktivnostima CIG bez čije pomoći ovi sastanci ne bi bili mogući. Njihova uključenost potvrđuje važan i stalan doprinos švajcarske diplomatije u očuvanju trajnog mira na Balkanu. Takođe smo zahvalni Lorensu Mereditu iz Evropske Komisije za njegovo veoma značajno učešće na oba sastanka i važne doprinose, kao i njegovim nadređenim kolegama iz Brisela, Stefanu Saninu i Pjeru Mirelu, za njihovu stalnu podršku i poverenje našim naporima i našoj misiji.

Takođe bismo iskoristili ovu priliku da zahvalimo Predsedniku CIG Upravnog odbora, profesoru Stivenu Burgu za njegovo aktivno učešće i uviđaje u vođenju rada CIG, kao i za savete i podršku naših drugih članova Upravnog odbora, Gordona Bardosa i Majkla Elfa.

Uloga CIG Potpredsednika Špetima Gašija u implementaciji ove inicijative je bila od neprocenjivog značaja. Zahvaljujemo se i našim kolegama iz Evrope, Arberu Kučiju, Ivani Stanojev i Mariji Govedarici na njihovom doprinosu.

CIG preuzima punu odgovornost za ovu publikaciju koja nije bila pregledana od strane učesnika.

Aleks N. Grigorev, Predsednik

*Njujork
Maj, 2012.*

OKRUGLI STO U BEČU

Rezime diskusija

Savet za inkluzivno upravljanje (eng. CIG) je u decembru 2011. godine u Beču organizovao okrugli sto za predstavnike srpskih i kosovskih političkih stranaka i vlada. Učesnici su bili članovi Demokratske stranke, G17 plus, Socijalističke partije Srbije, Liberalno demokratske partije i Demokratske stranke Kosova, Demokratske lige Kosova, Pokreta Samoopredeljenje, Alijanse za budućnost Kosova, Samostalne liberalne stranke, Ujedinjene srpske liste, kao i određeni broj analitičara iz Beograda i Prištine. Diplomate Švajcarske, Evropske Unije i SAD su takođe bili učesnici okruglog stola. Okrugli sto je bio sponzorisan od strane Saveznog ministarstva inostranih poslova Švajcarske.

Ideja za ovaj susret je proistekla iz razgovora koje je CIG imao sa mnogima od pozvanih tokom druge polovine 2011.godine. Naime, nekoliko preostalih nespornih na Zapadnom Balkanu, od kojih je najalarmantnija situacija na severu Kosova, sprečavaju zemlje regiona da obezbeđuju stabilnost i da brzo napreduju ka zajedničkom cilju dobijanja članstva u EU. CIG je sazvao sastanak u Beču sa ciljem da se potpomogne stvaranje novih ideja u pravcu rešavanja najhitnijih pitanja sa kojim se region danas suočava.

Različita pitanja u okviru programa bila su grupisana u opštu temu pod nazivom "Šta je potrebno da se razreše problemi severa Kosova?" Učesnici su bili pozvani da identifikuju sve one opcije za rešavanje krize koje treba da nastave da se razmatraju. Bili su ohrabreni da navedu glavne probleme sa kojima se suočavaju oni koji žive na severu i da predlože najbolja rešenja tih problema, da odrede kriterijum koji mora da bude ispunjen kako bi se došlo do rešenja prihvatljivog za sve strane, da razmotre inicijative koje postoje za Prištinu, Beograd i za Srbe na severu kako bi se razrešio spor, kao i da odrede moguće mere koje bi služile za izgradnju poverenja.

Kao što je to inače slučaj sa bilo kojim većim okruglim stolom, svi ciljevi programa nisu bili ispunjeni zbog čega je neophodno nastaviti sa održavanjem ovih sastanaka. Ono što sledi je rezime razgovora u Beču i njihovi zaključci. Da bi se podstakla otvorena diskusija, iznete primedbe nisu pripisivane imenima diskutantima, a CIG moli za razumevanje onih čije primedbe nisu u potpunosti prenete u ovom kratkom izveštaju. Učesnici su bili deo ovog okruglog stola u svom ličnom svojstvu i njihovi stavovi se nužno ne poklapaju sa stavovima organizacija koje predstavljaju. Učesnici nisu imali priliku da pregledaju ovaj izveštaj i zato CIG snosi svu odgovornost za njegov sadržaj.

Uvodni argumenti

Okrugli sto je bio otvoren od strane dva analitičara iz Beograda i Prištine. Oni su izneli pregled odnosa između Beograda i Prištine, kao i analizu sadašnje situacije na severu. Učesnik iz Beograda se osvrnuo na odnos između ekonomskih poteškoća i političkog ekstremizma. Slaba ekonomija, okarakterizovana visokim nivoom nezaposlenosti - oko 45% na Kosovu i 20% u Srbiji - utiče ne samo na živote Srba i Albanaca, već i na političke stavove Beograda i Prištine. On je tvrdio da u vremenima ekonomskih poteškoća vezivanje za temu nacionalizma je najbolji način za elitu da produži svoj boravak na vlasti i skrene pažnju javnosti sa stvarnih problema. I Beograd i Priština se suočavaju sa budžetskim deficitom, slabim ekonomskim rastom, korupcijom i široko organizovanim kriminalom. On je predložio da bi i Beograd i Priština trebali da otpočnu istinsku saradnju, a ne da to rade samo kad su pod pritiskom međunarodne zajednice.

Što se tiče krize na severu Kosova, jedan od govornika je rekao da spor nije samo između Beograda i Prištine, već i između Beograda i Srba na severu, između Prištine i tih istih Srba, između Beograda i međunarodne zajednice, kao i između Prištine i međunarodne zajednice. Dodao je i da Beograd treba da podrži rešenja od kojih imaju koristi i Srbi sa severa i Srbi sa juga. Takođe, upozorio je na "kriminalizaciju barikada na severu". "Dokle god neki ljudi na barikadama mogu biti kriminalci, problem je stvaran." Prema njegovoj tvrdnji, izvor problema nije u bezakonju; bezakonje je prosto rezultat, a ne uzrok, spora. Ni Beograd ni Priština ne mogu da funkcionišu ni napreduju uz takav konstantan politički i bezbednosni rizik. Poziv predsednika Tadića na uklanjanje barikada nije bio shvaćen ozbiljno od strane nekih aktera, jer su navodno postojale mere preduzete od strane srpskih zvaničnika koje su sprečile sprovođenje predsednikove poruke. Govornik je zaključio da je Vlada Kosova pridobila koristi iz ove situacije, najviše zato što nije uopšte reagovala.

Analitičar iz Prištine je odbacio tvrdnju koja se često može čuti, a to je da Srbi i Albanci ne mogu da žive zajedno. "Nema smisla reći da Srbi ne mogu zajedno da žive sa Albancima na Kosovu, dok druge etničke grupe u drugim zemljama to mogu, kao što su to na primer, Albanci u Srbiji i Makedoniji, Rusi u Ukrajni i Mađari u Rumuniji." Raspadom Sovjetskog Saveza, 25 miliona ljudi je ostalo van Rusije i oni su se prilagodili životu u svojim novim zemljama, naveo je govornik. Takođe je doveo u pitanje tvrdnju da su Srbi sa severa protiv integracije zbog njihovog straha od Prištine, dodajući da pri takvoj logici trebalo bi biti više straha među Srbima na jugu nego onima na severu. "Srbi sa severa žive kompaktno, tako da čemu strah?! Nasuprot njima, Srbi sa juga žive u oblastima okruženim albanskim stanovništvom."

Prištinski analitičar je primetio da je pristup Beograda ključni za integraciju Srba sa severa u kosovske institucije, ali da Beograd radi tome suprotno. "Beograd

koristi Srbe sa severa kako bi održao neku vrstu uticaja nad politikom Kosova i kako bi držao pitanje statusa Kosova otvorenim." Govornik se ukratko osvrnuo na političke opcije za sever i rekao da podela nije adekvatno rešenje, najviše zato što se tome oštro protive glavni akteri. Po njemu bi podela takođe imala posledice na region, naročito na Bosnu i Hercegovinu i na Makedoniju. Razmena teritorija je takođe malo verovatna opcija, koja je inače podržana od strane određenih delova srpskog i albanskog društva, ali se tome protivi međunarodna zajednica. Podela bi mogla da bude postignuta kroz tajne pregovore Beograda i Prištine, ali za sada je to malo verovatna mogućnost. Trećoj opciji, Ahtisarijevom planu plus, modelu koji bi omogućio dodatna prava Srbima sa severa se suprotstavljaju Albanci, najviše iz straha da bi mogao da ugrozi funkcionisanje države, kao i Beograd i Srbi sa severa, jer takva opcija ostavlja sever na Kosovu. Četvrta opcija, privremeni mali protektorat koji bi ojačao vladavinu prava bi možda bio prihvatljiv za Beograd i Prištinu, međutim međunarodnoj zajednici nije veoma stalo do ove opcije, prema zaključku učesnika.

Glavne teme diskusije

Beograd i Srbi sa Kosova

Učesnik, Srbin sa severa, tvrdio je da "Beograd možda koristi sever kako bi održao neku vrstu kontrole nad Kosovom, ali Priština nije zainteresovana za izgradnju partnerstva i ima nameru da šteti drugoj strani, naročito kada kaže da su kriminalne strukture te koje rukovode severom." Diskutant se složio da na severu ima kriminalaca, kao i na jugu, ali je rekao da oni nemaju dovoljno uticaja da određuju tok događaja. "Nisu problem kriminalci sa severa, oni su rezultat problema." Takođe je i rekao da stranci i Albanci imaju malo uticaja na severu i da samo Beograd može da reši ovu situaciju.

Isti učesnik je dodao da tvrdnje da su Srbi sa severa taoci Beograda ili da su kriminalci su netačne. "Srbi sa severa jednostavno hoće da uzmu sudbinu u svoje ruke." Bilo koje rešenje za sever da uspe, lideri Srba sa severa moraju da budu integralni deo bilo kojih pregovora o severu. Rekao je da veruje da se oni ne bi odrekli svega što sada imaju - nezavisnost lokalne samouprave, srpskih lokalnih institucija, samostalnih socijalnih služba (zdravstvenih i obrazovnih institucija, itd.) - nego bi tražili još više. Takođe je rekao da institucije na severu nisu paralelne već jedine koje postoje na severu, iako je priznao da su to srpske institucije, a ne kosovske, što je i suština spora. Ahtisarijev plan je neprihvatljiv za Srbe sa severa zato što daje nezavisnost Kosovu i ne predviđa dovoljno bezbednosnih i institucionalnih garancija za srpsku zajednicu. On je naveo da bi jedino plan koji bi pružio snažan institucionalni okvir za sever bio prihvatljiv za Srbe sa severa, ali nije naveo detalje kako bi takav plan izgledao, zaključivši da je rešenje za sever hitno.

Perspektive Srba sa Kosova

Na Kosovu postoje dve srpske realnosti: severna i južna, kako je rekao drugi srpski učesnik sa severa, tvrdeći da su Srbi sa juga na neki način bili "primorani" da se integrišu u kosovske institucije, pod tim podrazumevajući učešće na izborima, dobijanje ličnih karti, tablica za kola, ali da Srbi sa severa ne moraju da se integrišu. Oni se plaše od gubitka srpskog identiteta: "Mi jednostavno ne želimo da budemo deo Kosova. Nećemo kosovska dokumenta na kojima piše da smo Kosovari, a ne Srbi. Rešenje je u nekoj vrsti prilagođavanja granica."

Nekoliko Srba sa juga su tvrdili da kosovski Srbi sa juga nisu bili primorani da prihvate "surovu realnost", već su shvatili da je integracija najbolja opcija za poboljšanje njihovog životnog standarda. Srpski učesnik sa juga je takođe izrazio protivljenje ideji podele rekavši da bi to proizvelo ozbiljne negativne posledice za Srbe južno od reke Ibar. Dodao je da bilo koje rešenje za sever ne može da se donese zasebno i da mora da uzme u obzir posledice koje bi imalo za Srbe sa juga.

Drugi govornik, Srbin sa Kosova, razmotrio je neke od opštih događaja koji se tiču Srba sa juga. Veliki deo srpske populacije na Kosovu nije informisan o razlozima zbog kojih Srbi sa juga učestvuju u kosovskom političkom procesu. "Srbi nisu zadovoljni razvojem situacije i zbog toga su odlučili da učestvuju u kosovskim institucijama." Većina Srba na Kosovu živi južno od reke Ibar. Zbog teških uslova u kojima su živeli rešili su da se uključe u politički proces, naveo je govornik. Rekao je i da Srbi sa severa Kosova više nikome ne veruju, ni Prištini ni Beogradu, i da znaju "sta je ono što neće, ali ne i ono što hoće". Takođe je naveo da Vlada Kosova postiže prilično dobre rezultate s obzirom na situaciju, predloživši da bi isti model integracije za Srbe sa juga mogao da se primeni za Srbe sa severa.

Učesnik koji je sa severa Kosova je predočio listu problema koje su od ključne važnosti za narod sa severa, a to su ekonomski razvoj, nezaposlenost, identitet, povratak izbeglica, povraćaj imovine, nestala lica, pravna zaštita i rešavanje nerešenih sudskih slučajeva. Albanski govornik je naveo da su praktični problemi severa isti kao oni sa juga. Loše sudstvo, isključivanje struje, nestašica vode i nezaposlenost su u podjednako lošem stanju kod Albanaca. Drugi govornik je rekao da su to sve pitanja statusa. "Ne može se imati vladavina prava na severu bez razrešenog pitanja statusa i u suštini bez prethodnog dogovora čiji zakoni treba da se primenjuju." Predvideo je da osim ukoliko pripadnici međunarodne zajednice ne budu reagovali odlučno, sever će ostati zamrznut konflikt u godinama koje dolaze. Srpski učesnik se složio da će zamrznut konflikt da traje sve dok Srbija i Kosovo znaju gde su im granice. On je dodao da Beograd neće celo Kosovo. "Kada Beograd kaže "i Kosovo i EU", u stvari misli "sever Kosova i EU."

Pitanje identita je bilo pokrenuto od strane određenog broja učesnika. Nekoliko srpskih učesnika je reklo da se izraz "Kosovar" njima nameće. "Srbin sam već 50 godina i neću da sad menjam svoj identitet." Međutim, neki drugi govornici su rekli da Kosovar ne znači i Albanac. "Albanci takođe ne vole taj izraz." Izraz Kosovar je pridev koji označava pripadnost Kosovu, što drugim rečima znači stanovnik Kosova.

Priština i sever

